NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71208072-03838-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	15-942-03-0033365
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	16.05.2024 - 15:22
Komuna / Opština / Municipality:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Mitrovicë / Mitrovica / Mitrovicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71208072-03838-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna Imovina / Privately owned Land	Rural	74	Gjeodete.Diana Osmani Loshi Lic.251 Reg.Ndr.119/24	12.04.2024	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
UL.PIJAÇNI TRG			12.04.2024	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		74

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinsti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	EMINI BLERIM (ALI)	1007248454	ZHABAR I POSHTËM / ZHABAR I POSHTËM / ZHABAR I POSHTËM /			1/1	Marrveshja e Ndermjetesimit ONDK-82/11 Nr.18/24 dt.02.04.2024 Ndermjetesuesi B. Ismaili Reg.Ndr.107/24	15.04.2024




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MITROVICË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Mitrovicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71208072-03838-0	Parcelë / Parcela / Parcel	74



Shkalla/Razmera/Scale: 1:113

Punoi/Obradio/Created: Fatime Beqiri

Nënshkrimi/Potpis/Signature: 

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 16.05.2024

Koha/ Vreme/ Time: 03:37:57



Raporti i dokumentimit të gjendjes ekzistuese të objektit afarist me etazhitet P+1 në pronësi të z. Blerim Ali Emini-
Komuna e Mitrovicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Departamenti i Tatimit në Pronë - Departman poreza na imovinu - Property Tax Department

Raporti i gjendjes së objektit është i bazuar në shënimet e mara nga Formulari i Inqizimit të Strukturës dhe nga inspektimi në teren i realizuar më 21/05/2024.

Raporti i gjendjes së objektit afarist me etazhitet P+1 sipas kërkesës së Organit Shpronësues:
Komuna e Mitrovicës.

Me subjekt kërkesë: Kërkesë për vlerësim e pronave të paluajtshme komunale që janë objekt këmbimi - Referencë: 15-030/04-0033463/24 datë 17.05.2024 (Pranuar në MFPT nr.203/2024 protokoli, datë 17.05.2024).

Pronari:

Nr.	Emri	Emri i prindit	Mbiemri	Komuna	Zona Kadastrale	Ngastra Kadastrale
	Blerim	Ali	Emini	Mitrovicë	Mitrovicë	3838-0

1.0 PËRSHKRIMI I OBJEKTIT PËR VLERËSIM-GJENDJA EKZISTUESE

1.1 LOKACIONI

Objekti afarist me etazhitet P+1 dhe pronar z. Blerim Ali Emini gjendet në parcelën kadastrale me numër 3838-0 ZK Mitrovicë. Objekti ndodhet në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës më konkretisht në rrugën "Mbretëresha Teutë". Në anën veriore dhe perëndimore objekti ka qenë dhe është në kufi me dy objektet tjera afariste, ku në

anën veriore objekti tashmë është rrënuar, ndërsa në anën perëndimore gjendet ende objekti afarist ekzistues me etazhitet P+2. Në anën jugore në largësi 0.60m objekti është i larguar nga rruga Ali Zeneli, ndërsa në anën lindore në largësi min 6.70m dhe max 13.33m objekti afarist është i larguar nga rruga "Mbretëresha Teutë". Rrethina ku ndodhet objekti afarist përbëhet kryesisht nga objektet tjera ekzistuese të cilat janë shtëpi individuale të banimit, objekte kolektive me destinim të përzier banim me afarizëm, objekte afariste etj. Në afërsi të objektit nga ana lindore gjenden edhe objektet tjera shoqërore si SHFMU Anton Zako Cajupi, Muzeu i Mitrovicës, Xhamia e Isa Beut etj.



Foto 1. Lokacioni i objektit afarist me etazhitet P+1 – Ortofoto nga gjeoportali, 2018




Foto 2. Rilevimi gjeodezik me ortofoto i objektit ekzistues afarist me etazhitet P+1

1.2 ANALIZA ARKITEKTONIKE

Raporti i objektit afarist paraqet gjendjen ekzistuese të këtij objekti të evidentuar me rastin e hartimit të dokumentacionit teknik për vlerësimin e pronës të realizuar në muajin maj 2024.

Objekti me etazhitet P+1 ka zgjidhje funksionale në shërbim të afarizimit dhe përbëhet nga dy etazha (përdhese dhe kati). Objekti afarist ka qasje direkte në rrugën kryesore Mbretëresha Teutë, ndërsa sa i përket vitit të saktë të ndërtimit kjo mungon në Formularin e Inqizimit të Strukturës-(mirëpo si objekt figuron në imazhin satelitor-gjeoportalin i vitit 2009). Planimetria e objektit është katër këndëshe me dimensione bazë 8.07m x 10.53m në njërin anë dhe 6.61m x 11.22m në anën tjetër (sipas situacionit me koordinata rilevuar nga gjeodetja e licensuar Diana Osmani Loshi (lic nr. 251). Sipërfaqja e gjithmbarëshme buto e objektit (mar nga Formulari i Inqizimit të Strukturës) është **S-177.92m²** dhe atë përdhese ka sipërfaqe totale bruto S-83.79m² dhe kati parë ka sipërfaqe

totale bruto S-94.13m². Qasja në vetë objektin bëhet nga ana perëndimore e rrugës “Mbretëresha Teutë”. Rrethina ku ndodhet objekti afarist me e tazhitet P+1 është e përbërë kryesisht nga objektet tjera afariste, objekte banimi-shtëpi individuale, objekte kolektive me destinim të kombinuar afarizëm me banim etj.

Objekti ka një pamje të jashtme mesatare por është mjaft mirë i inkorporuar në kuadër të objekteve tjera për rreth dhe shtrirjes gjatësore pranë rrugës “Mbretëresha Teutë” e cila rrugë është mjaft e frekuentuar.

Bazuar në Ligjin e ndërtimit L-04/L – 110 ky objekt kategorizohet si „Objekt i kategorisë II“ pasi që shërben kryesisht për afarizëm.



Foto 3. Foto nga pjesa balllore - fasada lindore e objektit afarist -maj 2024



Foto 4. Foto e fasadës jug-lindore të objektit afarist-maj 2024



Foto 5. Foto e fasadës jugore të objektit afarist-maj 2024



Foto 6. Foto e fasadës veriore të objektit afarist-maj 2024



Foto 7. Foto e fasadës jug-lindore të objektit afarist-maj 2024




Foto 8. Dimensionet dhe sipërfaqja e përdhesës së objektit afarist me etazhitet P+1 mar nga Formulari i Inqizimit të Strukturës




Foto 9. Dimensionet dhe sipërfaqja e katit të objektit afarist me etazhitet P+1 mar nga Formulari i Inqizimit të Strukturës.

1.3 KONSTRUKSIONI DHE MATERIALI I NDËRTIMIT

Objekti është i ndërtuar me material të fortë nga beton armeja dhe nga pamja e jashtme duket mjaft i konsoliduar. Sistemi konstruktiv është skeletor i i kombinuar me shtylla dhe traje mbajtëse ndërsa muret ndarëse në brendi të objektit afarist dhe muret perimetrike janë të muratuara me blloka giter të argjilës. Konstruksioni meskator i përdhësës dhe i katit është i punuar nga betoni i armuar-pllakë e plotë njëjt si serkllazhet vertikale dhe horizontale të cilat poashtu janë nga betoni i armuar. Objekti mbulohet me kulmin një uJORë ku si mbulesë ka llamarinën e valëzuar të mbështetur në konstruksion nga druri (trajet , mahitë, listellat, kontralistellat etj).

Objekti në të dy etazhet përdoret për afarizëm. Nga përdhesa në pjesën e katit kalohet përmes shkallëve të punuara nga beton-armeja dhe të mveshura me pllaka graniti artificial ngjyrë okër. Si shtresë finale muret e mbrendshme të objektit te të dy etazhet (përdhesë dhe kati) kanë suvajën e ngjyrosur me ngjyrë të bardhë ndërsa dyshemetë te të dy etazhat si shtresë finale kanë pllakat e keramikës me njyrë okër.

Objekti afarist ka fasadë të punuar në anën lindore dhe jugore ndërsa në anën perëndimore objekti është i ngjitur me objektin tjetër ekzistues me etazhitet P+2 i cili poashtu përdoret për afarizëm, ndërsa në anën veriore objekti afarist nuk ka të punuar fasadë për arsye se ka qenë ngjitur me objektin tjetër i cili tashmë është rrënuar. Në anën ballore-fasadën lindore dhe një pjesë të fasadës jugore objekti afarist e ka të mveshur me pllaka alumili ngjyrë hiri si në pjesën e përdhësës poashtu edhe të katit përderisa dritaret në katë janë të punuara nga kornizat e alumilit dhe të mveshura me folie reklamuese nga ana e jashtme e dritateve. Objekti në përdhesë ka të punuar vitrinën hyrëse nga alumili me ngjyrë hiri për hapësirat e të dy lokaleve (objekti është i ndarë dhe në shfrytëzim të dy lokaleve). Një pjesë e vogël e fasadës jugore të objektit afarist është e punuar me fasadexs dhe e ngjyrosur me ngjyrë hiri. Në të tri anët në pjesën e sipërme objekti afarist ka të punuar murin e atikën e cila i jep një pamje të mirë moderne dhe njëkohësisht bënë të pamundur pamjen e kulmit.

Te hapsira e përdhësës dhe e katit nuk shihet që ka pasë punime me tendencë renovimi dhe mirëmbajtjeje për një kohë të gjatë, andaj për shfrytëzim të mëtutjeshëm të objektit rekomandohet renovimi emergjent dhe pastrimi i të gjitha hapësirave të mbrendshme të lokaleve.



Foto 10. Foto e lokalit në përdheshën e objektit afarist-maj 2024



Foto 11. Foto e lokalit në përdheshën e objektit afarist-maj 2024



Foto 12. Foto e lokalit në katin e objektit afarist-maj 2024

1.5 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Objekti afarist ka qasje në infrastrukturë publike - qasje direkte në rrugën kryesore "Mbretëresha Teutë" të qytetit të Mitrovicës e cila është e frekuentuar në qdo kohë, ka qasje në rrjetin elektroenergjetik të qytetit, rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, qasje në internet etj. Objekti nuk ka ngrohje qendrore por ngrohja bëhet në mënyrë individuale për secilën etazh veq e veq përmes inventoreve elektrik të vendosura në muret periferike të objektit nëpër etazhe.

1.6 INFRASTRUKTURA SOCIALE

Duke marrë parasysh që institucionet komunale dhe publike gjenden në afërsi të objektit si dhe frekuentimin e madh të njerëzve në atë pjesë mund të thuhet se objekti afarist me etazhitet P+1 gjendet në një nga zonat e mirë të qytetit të Mitrovicës.

Sipërfaqja totale bruto e objektit afarist me etazhitet P+1:

Etazhet	Sipërfaqja bruto e etazhit
Përdhesa	S-83.79m ²
Kati parë	S-94.13m ²
Gjithsej sipërfaqja bruto:	S-177.92 m²

Data e inspektimit : 21/05/2024

Data e hartimit të raportit: 27/05/2024

Punuar nga: Albana Bajrami, ing. Ark.







Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Formulari për procedim të lëndës për nënshkrim:

Përmes këtij formulari, nga personat nënshkrues **Konfirmohet** se, lënda e proceduar për nënshkrim, si Propozim -Vendim, Nr.prot. 02-463/22-0044000/24 datë 02/07/2024, Propozuar Kuvendit të Komunës, për sjellje të Vendimit Për Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës me Pronën në pronësi private, është në përputhje të plotë me Ligjin dhe aktet tjera juridike të aplikuara.

Nr.	Personi përgjegjës	Pozita	Nënshkrimi
1.		Propozues: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Artan Berisha- Drejtor	
2.		Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm i DPU-së Edison Tërnavë- Drejtor	
3.	<u>LULZIM HAYRA</u>	Zyra ligjore	

Datë: 02.07.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.08.2024
REFERENC-Ë:	02-060/21-0058821/24
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut znj. Vesa Broja, Kryesuese e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Bedri Hamza, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj. Drita Kadriu, Drejtore e Arsimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresë përcjellëse (Kërkesë për të miratuar propozimin për ndryshimin e thirrjes së shkollave të mesme të larta profesionale në <i>Institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional - IAAP</i>)

E nderuara kryesuese,

Duke u mbështetur në kërkesat e shkollave të mesme të larta profesionale të komunës tonë: ShMLM “Dr. Xheladin Deda”, ShMLE “Hasan Prishtina” dhe ShMLT “Arkitekt Sinani”, duke u mbështetur në Ligjin Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Neni 2, pika 1.2 dhe nenet 4, 5, 6, si dhe duke u mbështetur në Vendimin e MAShTI-t me Nr. 2/3726, të datës 28.08.2019, pikës 1, ku thuhet se të gjitha llojet e shkollave profesionale në Republikën e Kosovës janë të obliguara ta kenë emërtimin e tyre *Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)*, duke ju shënuar në vendimet e tyre Profilet që IAAP zhvillon, po ua përcjellim kërkesën për aprovim të ndryshimit të thirrjes së këtyre shkollave nga kuvendi komunal. Me këtë aprovim këto shkolla profesionale do të emërtohen:

- IAAP “Dr. Xheladin Deda”;
- IAAP “Hasan Prishtina”;
- IAAP “Arkitekt Sinani”

Duke shpresuar në aprovimin e këtij ndryshimi, ju falënderojmë paraprakisht!

Bashkëngjitur i gjeni kërkesat e shkollave dhe vendimin e MAShTI-t.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



1638

07-120/08-00480/24
16.08.2024

DATË/A:	15.08.2024
PËR/ZA/TO:	Drejtoria Komunale e Arsimit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	SHMLT. Arkitekt Sinani” – Mitrovicë Sami Rama- Drejtor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për emërtimin e SHMLT. Arkitekt Sinani” , Mitrovicë si Institucion i Arsimit dhe aftësimi profesional (IAAP) sipas vendimit të MASHT-it

Të nderuar,

Duke u bazuar në vendimin e MASHT-it numër 2-3726 të datës 28.08.2019 që të gjitha llojet e shkollave profesionale në Republikën e Kosovës janë të obliguara të kenë emërtimin e tyre Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP) duke ju shënuar në vendimet e tyre Profilet që IAAP i zhvillon. Andaj SHMLT.,, Arkitekt Sinani” Mitrovic, kërkon nga DKA në Mitrovicë që të fillon procedurat për shqyrtimin e kësaj kërkesë sipas vendimit të MASHT-it.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

07-610/CR 0038214/24

28.08.2024



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

1888

DATË/A:	28.08.2024
PËR/ZA/TO:	Drejtoria Komunale e Arsimit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	SHMLM,, Dr.Xheladin Deda” – Mitrovicë Dritë Zaraj Qamili- Drejtor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për emërtimin e SHMLM.,, Dr.Xheladin Deda” , Mitrovicë si Institucion i Arsimit dhe Aftësimiit profesional (IAAP) sipas vendimit të MASHT-it

Të nderuar,

Duke u bazuar në vendimin e MASHT-it numër 2-3226 të datës 28.08.2019 që të gjitha llojet e shkollave profesionale në Republikën e Kosovës janë të obliguara të kenë emërtimin e tyre Institucionet e Arsimit dhe Aftësimiit Profesional (IAAP) duke ju shënuar në vendimet e tyre Profilet që IAAP i zhvillon.
Andaj SHMLT.,, Arkitekt Sinani” Mitrovicë, kërkon nga DKA në Mitrovicë që të fillon procedurat për shqyrtimin e kësaj kërkesë sipas vendimit të MSHT-it.

Me respekt,



07-010/01-0057254/24
26.08.2024
REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

1669

DATË/A:	22.08.2024
PËR/ZA/TO:	Drejtoria Komunale e Arsimit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	SHMLE. Hasan Prishtina” – Mitrovicë Abdullah Bejtullahu- Drejtor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për emërtimin e SHMLE „Hasan Prishtina”, Mitrovicë si Institucion i Arsimit dhe aftësimi profesional (IAAP) sipas vendimit të MASHT-it

Të nderuar,

Duke u bazuar në vendimin e MASHT-it numër 2-3226 të datës 28.08.2019 që të gjitha llojet e shkollave profesionale në Republikën e Kosovës janë të obliguara të kenë emërtimin e tyre Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP) duke ju shënuar në vendimet e tyre Profilet që IAAP i zhvillon. Andaj SHMLE., „Hasan Prishtina” Mitrovicë, kërkon nga DKA në Mitrovicë që të fillon procedurat për shqyrtimin e kësaj kërkesë sipas vendimit të MASHT-it.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General
Secretary

Numër: 0.7.1.6

Datë: 28/03/2017

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare, nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 5 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 7 / 26 Mars 2013, nenin 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive më 22.03.2011 dhe në bazë të Kërkesave të Komunave, nxjerr:

V E N D I M

Për Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional

1. Të gjitha llojet e shkollave profesionale në Republikën e Kosovës janë të obliguara të kenë emërtimin e tyre Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP) duke ju shënuar në vendimet e tyre Profilet që IAAP zhvillon.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, si dhe në bazë të Kërkesave të Komunave për Emërtimin e Shkollave Profesionale deri në përfundimin e procesit të miratimit të dokumentit korniza e kurrikulit për sistemin e AAP-se dhe kurrikulat bërthame si dhe akte nënllogjore që i rregullojnë fushat, nën fushat, programet dhe kualifikimet me kodifikime ndërkombëtar si ISCED - FOET dhe ISCO 08, obligohen të gjitha shkollat dhe komunat të rregullojnë statutin e tyre bazuar në profilet dhe sektorët që mbulojnë duke respektuar kërkesat e tregut të punës, nevojë për zhvillim komunal duke respektuar në përputhshmëri të plotë legjislacionin në fuqi, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Të lartpërmendurve;
2. Zyrës së SP/MASHI;
3. Divizioni i Arsimit dhe Aftësimin Profesional;
4. Arkiv.

Elëon Kastrati

Sekretari i përgjithshëm/MASHI



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	30.08.2024
REFERENC-Ë:	02-400/01-0058673-2/24
PËR/ZA/TO:	Vesa BROJA – Kryesuese e Kuvendit
KOPJE :	Bedri HAMZA - Kryetar i Komunës së Mitrovicës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Igballe ISLAMI – Drejtore për Buxhet dhe Financa
NGA/OD/FROM:	Zenel ÇITAKU – Udhëheqës për Buxhet dhe Financa /ZKf
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për Dëgjimet Buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit të vitit 2025-2027

E nderuar,

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, si dhe nenit 6 pika 1.3 UA (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Qarkorës 2025/01, Drejtoria për Buxhet dhe Financa në koordinim me kryetarin e Komunës së Mitrovicës, në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive, Grupi Punues për dëgjime buxhetore 2025-2027 ka bërë organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026 dhe 2027.

Referuar në vendimin e kryetarit të komunës për formimin e Grupit Punues për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore 2025-2027 në Komunën e Mitrovicës së Jugut, grupi punues ka hartuar raportin me shkrim dhe i njëjti i është dërguar Drejtorëve të Drejtorive për trajtim/përgjigje në kërkesat e qytetarëve.

Në procesin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2025-2027 i kemi përfshi gjithsej 5 dëgjime buxhetore, prej të cilave dëgjimi i parë ka qenë për KAB - Komunal 2025-2027 dhe katër dëgjime për planifikimin e buxhetit komunal 2025-2027.

Metodat e konsultimeve	Data/Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve			Numri i atyre që kanë dhënë komente	Numri i kërkesave të pranuar
Takime të drejtpërdrejta me gjithë qytetarët e komunës të organizuara nga Grupi Punues për dëgjime buxhetore 2025-2027	16.07.2024	F	M	T	39	52
	23.07.2024	41	32	73		

Të gjitha kërkesat e parashtruara në dëgjime publike janë pjesë e raportit, ndërsa raporti i detajuar është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Me respekt!

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna nga qytetarët, të cilat i obligon drejtorët e drejtorive komunale që t'i shqyrtojnë këto kërkesa dhe varësisht nga natyra e kërkesës së qytetarëve të përgjigjet drejtoria përkatëse në dy kolonat e fundit të tabelës sipas kërkesës së tabelës.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat /Sygjerimet/ Komentetet	Kush ka dhënë kërkesë / sygjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës/sygjerimi i pranuar, pjesërisht i pranuar/ apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
Dëgjimi buxhetor me qytetarë për Draft-Buxhetin	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesë për ndriqimin e rrugës kryesore “Martirët e Vinarcit” 2. Rregullim i tretuarit në rrugën “Martirët e Vinarcit” (3 km gjatësi). 3. Kërkesë për ansore tek vendi i quajtur “kërrshi”. 	Lulzim Hasani Vinarci i Eperm	<p>1.Presim te kemi kontrate dhe te fillojme me zgjerimin e rjetit.</p> <p>2-3 Kemi kontrate aktive per rregullimin e rrugeve, do te trajtohen edhe keto kerkesa..</p>	
	<ol style="list-style-type: none"> 4. Rregullimi i rrugëve në fshatin Bajgorë (Mullinjët, Hakif Mehmeti, Zahir Istrefi, Ramë H Uka, Alpet shqiptare, Dy Martiret Osman Musa). 5. Rregullimi 4 Pritoreve. 6. Ndriqimi publik. 7. Rregullimi I tretuareve, ujësjellësit dhe ujrave të zeza. 8. Rregullimi dhe asfaltimi I rrugës në fshatin Kaqandollë. 9. Kërkesë për ndriqim public në fshatin Kaqandollë. 10. Kërkesë për rregullimin e ujësjellësit, ndriqimin public dhe ujrave të zeza në fshatin Kovaqicë. 11. Rregullimi dhe asfaltimi I rruges që lidhë fshatin 	Faton Beqiri Bajgorë	<p>-5-7-8-11. E kemi ne planifikim buxhetor presim te lidhet kontrata.</p> <p>6-9. Eshte ne proces tenderues (te lidhet kontrata) Do te kemi parasysh kerkesen per Bajgore.</p> <p>10.Eshte ne planifikim buxhetor</p>	

2025-2027 Komuna e Mitrovicës Salla e kuvendit 16.07.2024, E Martë ora 14:00	Kaqandollë me fshatin Orzhan.			
	12. Kërkesë për një qender për Kultur, Rini dhe Sport, të largohet qendra kolektive dhe në atë parcel të ndertohet kjo qender. 13. Ndertimin e një objekti për strehimin e të moshuarve parcela është me mbi 2.5 hektar, që është një kapital i madhë për Mitrovicën. 14. Kamerat e sigurisë.	Salih Meha Fsh. Shipol		
	15. Të perfundoj tretuari i filluar në fillim të këti viti, të bëhet edhe ndriqimi. 16. Në lagjen “Kllovit” të bëhet ndertimi I rrugës nga zona ku bashkohet me fshatin Zupç si dhe ndriqimi i lagjës. 17. Të rregullohen edhe disa rrugë dhe ujrave të zeza.	Haxhi Salihu Fsh.Koshtovë	15.Jemi duke bere rregullimin e tretuarit, afer perfundimit. 16. Presim te kemi kontrate dhe te fillojme me zgjerimin e rjetit. 17.E kemi ne planifikim buxhetor te trajtohen rruget ne koshtove.	
	18. Rregullimi dhe asfaltimi I rrugës së fshatit Koprivë, e cila e ka projektin e detajuar.	Xhelazim Baliu Fsh. Koprivë	18.E kemi ne planifikimin buxhetor.Per asfaltimin e rruges ne Koprive.	
	19. Renovimi i ndërtesës sportive ish “Partizani” e tani “Fatime Xhaka”. 20. Renovimi dhe izolimi i ndërtesës së Omni Sportit. 21. Kërkesë për mbikqyrje profesionale në ndertim të	Asllan Vitaku Mitrovicë		

	ndërtesave.			
	22. Ndertimi I rrugës “Ramadan Ahmeti” kërkohet vendosja e një tretuarit. 23. Ndertimi I rrugës që lidh skenderajin nga ana e djatht, rrugë që fillon nga lagjja Bashkimi dhe vazhdon tek vullkanizeri Behari (150m), dhe vendosja e 3 poqave elektrik.	Musli Osmani Fsh. Zhabar I ulët	22-23. E kemi ne planifikim buxhetor rregullimin e rrugeve ne Zhabar.	
	24. Kërkesë për realizimn e kërkesave të derguara në drejtorit perkatese (kerkoj realizimin nga Kryetari i Komunës- të realizohen në buxhetin 2025-2027).	Osman Cimili Fsh. Melenic		
	25. Rregullimi i ujrave të zeza (të mbyllura). 26. Ndriqimi i fshatit Frasher i vogël. 27. Rregullimi I rrugës “Faruk Spahija”(80m). 28. Kapaciteti i pompave të ujit është i vogël (fshatarët mbesin pa ujë të pijes).	Mustaf Preshtreshi Fshati Frasher	25.Eshte ne planifikim buxhetor 26. Presim te kemi kontrate dhe te fillojme me zgjerimin e rjetit. 27.Eshte ne planifikim buxhetor.	
	29. Rregullimi I ujrave të zeza. 30. Përfundimi i 3 rrugëve të lëna në gjysmë.	Asllan Hasani Fsh. Zhabar i poshtëm	29.Eshte ne planifikim buxhetor. 30.Eshte ne planifikim buxhetor	
	31. Rregullimi i rrugëve të dëmtuara në fshatin Vllahi dhe Ziaq. 32. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Vllahi – Zhazh (6km). 33. Rregullimi i ujësjellësit ne fshatin Vllahi.	Safet Kurti Fsh. Vllahi	31.Eshte ne planifikim buxhetor. 32.E kemi futur ne buxhetin 2025-2027. 33.Eshte ne planifikim buxhetor.	
	34. Rregullim i tretuarit në rrugën “Shaqir Avdiu”. 35. Ndriqimi publik në lagje. 36. Rregullim i rrugës “Mulliri i vjeter”. 37. Përfundim i rregullimit të rrugës së “Jazit”. 38. Mbyllja e pusetave.	Xhafer Jaha Fsh. Zhabar i poshtëm	34.Eshte ne proces tenderues (te lidhet kontrata) 35.Eshte ne proces tenderues (telidhet kontrata)	

	<p>39. Renovimi i shkollës.</p> <p>40. Ndertimi i një salle sportive.</p> <p>41. Kërkesë për qerdhe të fëmijëve.</p> <p>42. Instalimi i kamerave në oborrin e shkollës në Zhabar dhe në hapsirat tek liqeni Akomulues.</p>		36. Eshte ne proces tenderues (telidhet kontrata)	
<p>Dëgjimi I Dytë buxhetor Kulturë Rini dhe Sport, Shoqërit Civile dhe Komunitete tDraft-Buxhetin 2025-2027 Komuna e Mitrovicës Salla e kuvendit 17.07.2024, e Merkurë ora 14:00</p>	<p>43. Përkrahje ekstra financiare për KF Mitrovica – Femrat në garat Evropiane në ligën e kampioneve për femrat.</p>	Asllan Vitaku Mitrovicë		
	<p>44. Të zvoglohet perkrahja financiare për klubet e futbollit dhe basketbollit për meshkujt dhe të rritet përkrahja financiare për klubet e hendbollit për femrat dhe meshkujt, basketbollit dhe futbollit të femrave.</p> <p>45. Të përkrahjet financiarisht KA Trepça dhe Shahu Minatorët.</p> <p>46. Të sqarohet qështja proneso-juridike e stadiumit “Xhemajl Isufi”-Xheki spse BE ka investuar për të gjitha komunitetet dhe jo vetëm për SH.F “Australia “.</p> <p>47. Të largohet “Diagonia” nga prona e palestres Minatori dhe të ju ipen zyret për klubet e qytetit.</p>	Krenar Kaçaniku Mitrovicë		
	<p>48. Ndarje të buxhetit për hapsira publike, në drejtim të permisimit të jetës në komunitet.</p> <p>49. Investime në prietore (stacione).</p>	Blerta Brezhnica Ojq Pse Mitrovicë		
	<p>50. Subvencionet për klubet të planifikohen me kohë deri ne muajin Mars-Prill.</p> <p>51. Në KH Trepça subvencione me rritjen e buxhetit për vitin 2025 nga ana e DKRS-Mitrovicë.</p>	Taib Kabashi KH Trepça		
	<p>52. Kërkesë për përkrahje financiare për klubin e basketbollit Trepça “Veteranet”.</p> <p>53. Renovimi i palestres së “ Omni sportit”, si dhe kordinime për</p>	Naim Hajrizi Mitrovicë		

	<p>aktivitete të klubit.</p> <p>54. Të ndertohen edhe disa hapsira të hapura për fusha të basketbollit.</p>			
	<p>55. Përbërja e komisioneve të cilat vendosi për shpërndarjen e subvencioneve për organizata të jetë publike paraprakisht dhe personat të cilët zgjedhën të mos jenë njerez jo kredibil dhe po ashtu mos të jenë homofob, seksist apo politikisht të përfshirë.</p> <p>56. Mjete për diplomaci kulturore.</p> <p>57. Renovimi i qendrës së kulturës mbrapa, dhe renovimi i “Omni sportit”.</p>	Neri Ferizi Mitrovicë		
	<p>58. Kërkesë që në komisionet përzgjedhëse të ketë përfaqësues rinor.</p>	Mehmet Salihu		
	<p>59. Kërkesë për përkrahje financiare në emër të K.Ç. “Trepça” për t’i realizuar aktivitetet e tyre për vitin 2025, I duhen rreth 8,000.00 Euro. Të gjitha aktivitetet në total janë 23 gara Brenda dhe jashtë vendit.</p>	Edmond Kumnova Mitrovicë		
	<p>60. Asfaltimi i rrugës “Ilmi Cimili” dhe “Voce Gimaj”.</p> <p>61. Shtrimi me zhavor i rrugës “Halim Cimili”.</p> <p>62. Asfaltimi i rrugicave në lagjën “Meholli” dhe “Hysenaj”.</p> <p>63. Të shiqohen mundësit për të siguruar ujin e pijshëm në këto fshatra.</p> <p>64. Të shtrohen disa rrugë me zhavor në fshatin Maxherë.</p>	Osman Cimili Fsh. Melenicë		
	<p>65. Kërkesë për ekspozit të pikturave.</p> <p>66. Kërkesë për punëseim (drejtimi dizajn modern).</p>	Sahadete Hajrizi Mitrovicë		
Dëgjimi i Tretë buxhetor Shëndetsi	<p>67. Rezervar të ujit për QMF-AMF-të.</p> <p>68. Vendosija e klimave.</p> <p>69. Gëlqerosja – renovimi Bair 1</p> <p>70. Aneks në AMF- Kçiq.</p>	Meleqe Morina		
	<p>71. Kërkesë për paisje moderne për mirëmbajtje të objektit si dhe një puntorë mirëmbajtës.</p>	Lutvi Peci QMF - Iliridë		

Draft- Buxhetin 2025-2027 Komuna e Mitrovicës Salla e kuvendit 18.07.2024, e Enjtë ora 14:00	72. Rinovimi në terësi i AMF – Fidanishtë.			
	73. Kërkesë për 3 kondicionerë (klima).	Bajram Rama QMF- Bair 2		
	74. Ngjyrosja (gelqerosja) e objektit brenda.			
	75. Vendosja e një piste për përsona me nevoja të veqanta.			
	76. Renovimi i bodrumit QMF- Bajr 2.			
	77. Vendosja e një dere që lidh bodrumin me katin e parë.			
	78. Sigurimi i ngrohjes elektrike.			
	79. Rrethoja e objektit.			
	80. Kërkesë që të bëhet zgjedhje për klimatizimi dhe ventillimin e hapsirave, duke pasur parasysh temperaturat e larta dhe mundësia e dëmtimeve të barnave nëpër qendra shkak temperaturave të larta.	Sokol Haliti		
81. Aftësimi apo sigurimi i një aparati të ri për ftohje të ujit të pijëshëm në repartin e stomatologjisë.	Eshref Hasani			
82. Kërkesë për mjete pune si frizere, per zgjerim te biznesit.	Arjeta Behrami Mitrovic			
83. krkese per mjete pune (ushqime tradicionale) biznes individual.	Violeta Islami Mitrovicë			
84. Kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale) biznes individual.	Arbenita Brahimi Shipol			
85. Kërkesë për panairë (për të promovuar produktet tona me gatime tradicionale).				
86. Kioska për shitje të produkteve.	Fatmire kurti Mitrovicë			
87. Mbajtje më e shpeshtë e panairëve.				
88. Merrem me blegtori dhe gatime tradicionale, kërkoj ndihme rreth një shtalle.	Vjollca tupella Fsh. Kçiq			
89. Kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale).				
90. Kërkesë për mjete pune, salon për frizere.	Shadije hasani Mitrovicë			
91. Kërkesë për paisje (rrobaqepsi).	Kimete Arifi Rr. “Cen Stantergu”			

Dëgjimi i Katërtë buxhetor Gratë dhe Vajzat Draft- Buxhetin 2025-2027 Komuna e Mitrovicës Salla e kuvendit 23.07.2024, e Martë ora 14:00	92. Rregullimi i infrastruktures në Shupkovc.	Syzana Preteni Fsh. Shupkovc		
	93. Krijimi i mundësive për punësim.			
	94. Kërkesë për kioske (për shitje të produkteve punëdore).	Sevdije Aliu Mitrovicë		
	95. Kërkesë për mbajtje të panairove më shpeshë.			
	96. Si themeluse e OJQ “Hareja” në Mitrovicë kërkojë përkrahje për marrjen e një lokali për takime me grupin e grave.	Hadije Ahmeti Mitrovicë		
	97. Kërkesë për kioske - lokal (për shitje të produkteve punëdore).	Kumrije Kamberi Mitrovicë		
	98.			
	99. Kërkesë për një lokacion për shitjen e produkteve punëdore, ushqime tradicionale etj.	Sadete Brahimi Broboniq		
	100. Kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale).			
	101. Përkrahje financiare për Strehimoren QMGF “Raba Voca”.	Fidane Hyseni Rr. “Ramadan Peci”		
	102. Kërkesë për mjete pune si frizere, për zgjerim të biznesit.	Shyhrete Brahimi Fsh. Kçiq i Madhë		
	103. Kërkesë për kioske (për shitje të produkteve punëdore).	Hamide Tahiri Mitrovicë		
	104. Kërkesë për mbajtje të panairove më shpeshë.			
105. Kërkesë për bursa për nxënësit të shkollave të mesme.	Fatmire Gerxhaliu Rr. “Zahir Pajaziti” Mitrovicë			
106. Kërkesë për psikologë në shkollat e mesme.				
107. Asfaltimi i rrugës “Faqja e Lemutë” në Broboniq, e cila është lënë në gjysmë.	Xhevrijje Doroci Fsh. Broboniq			
108. Kërkesë për kioska (për gratë që merren me artizanale).	Xhylinaze Zatriqi Mitrovicë			
109. Kërkesë për mjete pune për zgjerim të biznesit blegtari.	Emine Brahimi Fsh. Kçiq Madhë			

<p>110. Kërkesë për zgjerim të rrugës kryesore Shupkoc – Zasellë, së paku deri tek restoranti në fshat.</p>	<p>Maliqe Mustafa Fsh. Zasellë</p>		
<p>111. Kërkesë për perkrahje për punësim.</p>	<p>Sahadete Hajrizi Rr. “Avni Shabani”</p>		
<p>112. Kërkesë për mjete pune (ushqime tradicionale).</p>	<p>Shukrije Muharremi Mitrovicë</p>		
<p>113. Kërkesë për mjete pune për zgjerim të biznesit (ushqime tradicionale). Kërkesë për mbajtje të panairëve.</p>	<p>Arbenita Brahimi Shipol</p>		
<p>114. Të rritet ndihma ose së paku dy herë në vit të subvencionohen gratë e sëmuara me kancer.</p> <p>115. Të i’u sigurohen medikamente bazë (gratë e prekura me kancer).</p> <p>116. Vazhdimi i pagesave të qirave.</p> <p>117. Vazhdimi dhe rritja e perkrahjeve financiare dhe ushqimore.</p> <p>118. Të ndihmohen OJQ (me persona me aftësi të kufizuar) edhe financiarisht – Handikosi.</p> <p>119. Të ndahet një hapsirë, objekt ku pensionistet mund të kalojnë kohën (mundësisht hapsira të posedojnë bibliotekë dhe materiale për argëtim).</p> <p>120. Për grupin e grave “Gratë e Mitrovicës lexojnë” të ndahet një hapsirë ku ato mund të takohen dhe komentojnë romanet (shpresojmë në objektin e bibliotekës së re të gjendet një vend i tillë).</p> <p>121. Të rregullohet ndriqimi në lagjen “Adem Voca”</p> <p>122. Në lagjen “Adem Voca” në ambullantë nuk ka mjekë të rregulltë si dhe</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR</p>		

	<p>mungojnë vizitat e rregullta të mjekëve dhe barnat esenciale.</p> <p>123. Të përkrahen me bursa modeste vajzat e komunitetit ashkali si dhe punësimi i tyre.</p> <p>124. Hapja e biznesit të rrobaqepesisë në “Roma Mahallë”.</p> <p>125. Të riaktivizohet zyra policore e cila që një kohë të gjatë është pa zyrtare policor.</p>			
	<p>126. Vendosja e kiosqeve të premtuara në një hapsirë të caktuar.</p> <p>127. Të percaktohet vendi i organizimit të panairove – sheshi Adem Jashari.</p> <p>128. Grante të vogela: për kavanoza dhe tenxhere për prodhimin e turshive, ajvarit.</p> <p>129. Organizimi i vizitave studimore.</p> <p>130. Transporti për ndërmarrëse të cilat marrin pjesë në panairë në qytete të tjera të Kosovës.</p> <p>131. Të rregullohet rruga “Kristalet” në Trepçë.</p> <p>132. Ulja e taksave për biznese të vogla fillestare.</p> <p>133. Kërkesë për ndryshim të kriterëve për subvencionim (në favor të grave).</p> <p>134. Subvencionim i grave që merren me punime artizanale.</p> <p>135. Subvensioni i grave ndërmarrëse për zgjerim biznesi.</p> <p>136. Të organizohen me shumë panairë ndoshta në cdo dy muaj.</p> <p>137. Të organizohen vizita studimore në rajon për shkëmbim të përvojave dhe ide për zhvillim të bizneseve të reja.</p> <p>138. Të organizohen trajnime për veprimtari të cilat merrën gratë.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR- Kërkesat e grave ndërmarrëse</p>		

	<p>139. Të sigurohet transporti për antarët e organizates “Së Bashku”.</p> <p>140. Të i’u mundësohet qasja në katete e epërme të objektit të komunes për persona me aftësi të kufizuara.</p> <p>141. Në objekt të komunës të vendosen tualete për persona me aftësi të kufizuara.</p> <p>142. Tualete publike në qytet për persona me aftësi të kufizuara.</p> <p>143. Të vendosen në rruë vija për të verbër dhe për karroca.</p> <p>144. Të renovohet zyra e shoqatës së të verbërve.</p> <p>145. Mundësi punësimi për persona me aftësi të kufizuar punë me kohë të pacaktuar dhe jo vetëm praktik për 6 muaj.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e personave me aftësi të kufizuar</p>	<p>145 Komuna e Mitrovices është e obliguar të respektoj ligjet dhe aktet ligjore në fuqi për punësimin e personave me aftësi të kufizuar për momentin numri I personave me aftësi të kufizuar është sipas ligjit në fuqi dhe I inkurajojm personat me aftësi të kufizuar për aplikim në vendet e punës për të rritë numrin në institucione.</p>	<p>141. Në vitin 2025-2026 do të bëhet tualeti për persona me aftësi të kufizuara. 140. Është planifikuar për vitin 2024-2025 të vendoset ashensori për persona me aftësi të kufizuar.</p>
	<p>146. Bursa për vajzat Rome/Ashkallike.</p> <p>147. Mundësin e regjistrimit të vajzave Rome/Ashkallike në shkollën e mesme të mjeksisë.</p> <p>148. Stimulimi i vajzave për tu regjistruar në shkollën e mesme të teknikes përkrahjes me bursa.</p> <p>149. Bursa për vajza nga viset rurale.</p> <p>150. Ndërtimi i konviktit për vajzat nga viset rurale.</p> <p>151. Angazhim I mësimdhënësve mbështetës për nxënësit me nevojë fizike.</p> <p>152. Të ndahet më shumë buxhet për mjete digjitale.</p> <p>153. Emerimi i psikologëve në shkollë.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e grave mësimdhënëse</p>	<p>146. Komuna e Mitrovices që nga viti 2021 I ka 10 vende të rezervuara për komunitete</p> <p>149. Komuna e Mitrovices ka rritur numrin e bursave nga 50 në 230 bursa dhe në të përfshihen të gjithë qytetarët e komunës së Mitrovices duke u bazuar në statutin e saj dhe rregulloret në fuqi.</p>	
	<p>154. DKA të parashehë buxhet për transport të mësimdhënësve dhe nxënësve.</p> <p>155. Të i’u mundësohet nxënësve të hapin një kuzhinë në shkollë (të i’u</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights</p>	<p>156. Në shkollën e mesme teknike janë 50 bursa për nxënësit të shkolqshëm</p>	

	<p>sigurohen paisjet përkatëse).</p> <p>156. Të shpërblehen me bursa nxënësit e shkëlqyeshëm.</p> <p>157. Më shumë mjete për gjelbrimin e hapsirave shkollore.</p> <p>158. Mbështetje shtesë me paisje shkollore për nxënësit me kushte ekonomike të vështira.</p> <p>159. Në shkollat ku nuk ka qasje për karroca, të ndërtohen.</p> <p>160. Të rritet shuma e përkrahjes për organizatat që të ketë aktivitete më cilësore.</p> <p>161. Ndërrim i rregullorës për bursat e studenteve (të i'u mundësohet edhe studentëve të vitit të parë).</p> <p>162. Të organizohen sesione informuese në fshatra.</p>	<p>MWAHR - Kërkesat e të rinjëve</p>		
	<p>163. Të përkrahen klubet e grave.</p> <p>164. Të rritet buxheti mbështetës i OJQ-ve sportive.</p> <p>165. Të ndërtohet një fushë sporti për klubin futbollistik të grave.</p> <p>166. Thirrjet publike për mbështetje të bëhen në fillim të vitit.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e klubeve sportive</p>		
	<p>167. Të rritet buxheti për ndarjen e granteve për grupet e grave të shoqëris civile.</p> <p>168. Në bashkëpunim me OJQ e grave të organizojnë trajnime për zyrtarë komunal (për mekanizmat mbrojtës nga dhuna, vendor dhe ndërkombetar).</p> <p>169. Të sigurohen hapsira – zyra OJQ të grave aktive.</p> <p>170. Të rritet shuma e grantit për përfaqesuesit e granteve nga zyra për barazi gjinore.</p>	<p>Mitrovica Women association for Human Rights MWAHR - Kërkesat e përfaqësuesve të shoqërisë civile</p>	<p>167. Komuna e Mitrovices prej vitit 2021 ka rritur buxhetin për ndarjen e granteve për grupet e grave të shoqërisë civile për 20,000.00 euro.</p>	